



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit, 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, Kryetari i Komunës, propozonë që :

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika c), nenit 17 dhe 40 paragrafi 40.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 9 ,19 paragrafi 19.4 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit, 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008 Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2021, të miratojë këtë:

PROPOZIM

RREGULLORE

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR VARREZAT,
OFRIMIN E SHËRBBIMEVE TË VARRIMIT, RREGULLIMIN DHE MIRËMBAJTJEN
E TYRE 15NR.011-71878 E DATËS 27.11.2018

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Rregullore, ndryshohet dhe plotësohet neni 12 i Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre 15NR.011-71878 e datës 27.11.2018 dhe riformulohet, si në vijim :

Neni 12

Shërbimet e Varrimit

- 1.Komuna e Lipjanit me këtë Rregullore obligohet që brenda mundësive dhe kapaciteteve buxhetore të Komunës t'i subvencionojë shpenzimet për shërbimet e varrimit për qytetarët me vendbanim të përhershëm në Komunën e Lipjanit.
2. Shërbimet e varrimit do të bëhen konform riteve të komuniteteve fetare dhe dispozitave të Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre .
3. Procedurat e subvencionimit të shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Komunës do të përcaktohen me Vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës.

Neni 3 Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare elektronike të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për të miratuar këtë Propozim Rregullore është përcaktuar në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika c), nenit 17 dhe 40 paragrafi 40.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 9 ,19 paragrafi 19.4 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit, 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008.

Me këtë Propozim - Rregullore propozohet të ndryshohet neni 12 – Shërbimet e varrimit siq është përkufizuar në dispozitiv të kësaj Propozim Rregulloreje.

Me ndryshimin e këtij neni ndryshohen forma e deritanishme e subvencionimit të shpenzimeve për shërbimet e varrimit e cila do të qartësohet më detalisht me Vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës

Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e kësaj Propozim Rregulloreje.

1Nr. 011 - 9005

Lipjan, më 12-02-2020

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

